



SHËRBIMI I NDËRMJETËSIMIT GJUHËSOR-KULTUROR

për profesionistët e shërbimit dhe familjet emigrante

Ndërmjetësimi gjuhësor-kulturor përfaqëson një veprimtari konstruktive që **lehtëson dialogun dhe bashkëpunimin midis emigrantëve e shoqërisë pritëse**, për të nxitur njohjen reciproke të kulturave, të vlerave, të traditave, të të drejtave e të sistemeve shoqërore, në perspektivën e shkëmbimit dhe të **pasurimit të ndërsjellë**.

Ndërmjetësi gjuhësor-kulturor është një **profesionist** që kryen veprimtarinë e interpretuesit gjuhësor, të përkthyesit dhe të orientuesit kulturor, **duke vepruar si “ure”** midis nevojave të emigrantëve dhe mundësive të ofruara nga organet publike dhe strukturat private italiane.

Nëpërmjet një **formulari** të posaçëm do të mundet të kerkohet lehtësisht pjesëmarrja e ndërmjetësit gjuhësor-kulturor gjatë takimeve, shkëmbimeve ose në kontekste të tjera.

Qëllimi, kujt i drejtohet dhe profesionistët e përfshirë

Më hollësisht

Ky shërbim synon t'u ofrojë **mësuesve** dhe **familjeve** një **mjet mirëkuptimi reciprok**, një interpretim gjuhësor-kulturor koherent gjatë shkëmbimit të njohjes dhe komunikimit.

Falë **bashkëpunimit** ndërmjet **koordinuesve të shërbimit të ndërmjetësimit gjuhësor-kulturor**, të ndërmjetësve gjuhësor-kulturor, të **shkollës** e **familjeve**, do të bëhet i mundur mirëkuptimi i ndërsjellë midis subjekteve.

Veçanërisht në kontekstin e shkollës do të nxitet mënyra e **shkëmbimit dhe njohja midis kulturave** të nxënësve të ndihmuar dhe grupit tjetër të klasës.

Ndërmjetësi gjuhësor-kulturor mund të jetë i pranishëm gjatë takimeve shkollë-prindër dhe shërbim social-familje për të patur njohuri dhe mirëkuptim sa më të lartë midis subjekteve.

Per informazione dhe sqarime

Ufficio di Piano-Ambito di Merate

mail: anna.debona@retesalute.net

tel: **039 9193617**

Associazione Ale G

mail: coordinamento@aleg-onlus.it

Les Cultures

mail: giulia.julita@lescultures.it